

VENDIM
Nr.682, datë 25.8.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË
FAKULTETIN E DREJTËSISË TË UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI”,
SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 26, 34 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Hapjen, në fakultetin e drejtësisë të universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të programit të studimeve të ciklit të dytë “E drejta kushtetuese dhe administrative”, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë e Nivelit të Dytë, (DND), në “E drejta kushtetuese dhe administrative”.

2.Ky program studimesh i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike.

3.Programi i studimeve “E drejta kushtetuese dhe administrative” të fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, pa efekte buxhetore shtesë.

5.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha